



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 127

Ora: 11:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA LËVIZJA E RE”, PËR REGJISTRIMIN SI  
SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ  
2023**

Sot më datë 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 1235 Prot., datë 1.3.2023, me:

**Kërkues:** Partia politike “Partia Lëvizja e Re”, me kryetar z. Arian Galdini

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Lëvizja e Re” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

**V Ë R E J:**

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

“Partia Lëvizja e Re”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Arian Galdini, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Data: 8.3.2023 Nr: 127  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Lëvizja e Re”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 6.2.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Lëvizja e Re”, me iniale “LRE”, me kryetar z. Arian Galdini rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike, (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Lëvizja e Re” me shkronja nistore “LRE”, me adresë Pallati i “Turkeshëve”, në Kryqëzimin mes Rruga “Qemal Stafa” dhe Rruga “Derhemi”, kati i 2-të, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Arian Galdani, me adresë Pallati i “Turkeshëve”, në Kryqëzimin mes Rruga “Qemal Stafa” dhe Rruga “Derhemi”, kati i 2-të Tiranë;
- c) Financieri i partisë është z. Arsen Laziri, me adresë Pallati i “Turkeshëve”, në Kryqëzimin mes Rruga “Qemal Stafa” dhe Rruga “Derhemi”, kati i 2-të, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është znj. Kristina Nano, me adresë Rruga Pallati i “Turkeshëve”, në Kryqëzimin mes Rruga “Qemal Stafa” dhe Rruga “Derhemi”, kati i 2-të, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Lëvizja e Re”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga “Partia Lëvizja e Re”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenet 64, pika 2 dhe 92 /2 pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr.1, datë 18. 1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

#### **VENDOSA:**

Data: 8.3. 2023 Nr: 127  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Lëvizja e Re”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Lëvizja e Re”, me kryetar z. Arian Galdini, me shkronjat nistore “LRE”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**